



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 18/07/2022 Ref.: 953/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018) dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 101-të, të mbajtur më 30.06.2022 dhe 102-të të mbajtur më 14.07.2022, mori:

V E N D I M

- I. **Riakreditohen** programet e studimit të Kolegjit UBT, për periudhën pesë (5) vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2027:
 1. *Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc*, 180 ECTS, maksimumi 550 studentë për vit akademik,
 2. *Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, MSc*, 120 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik,
 3. *E drejta Civile dhe e Pronës, LLM*, 60 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik,
 4. *Arti dhe Mediat Dixhitale, BA*, 180 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik.

- II. **Riakreditohen** programet e studimit të Kolegjit UBT, për periudhën tre (3) vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2025:
 5. *Inxhinieri e Mekatronikës, BSc*, 180 ECTS, maksimumi 140 studentë për vit akademik,
 6. *Inxhinieri e Mekatronikës, MSc*, 180 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik,
 7. *Teknik i Radiologjisë, BSc*, 180 ECTS, maksimumi 40 studentë për vit akademik.

- III. **Akreditohen** programet e studimit të Kolegjit UBT, për periudhën tre (3) vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2025:
 8. *Shëndeti dhe Aktiviteti Fizik, MSc*, 120 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik,
 9. *Biokimi Mjekësore, BSc*, 180 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik,
 10. *Shkenca Paramjekësore, MSc*, 120 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik,
 11. *Aktrim, BA*, 180 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik.

- IV. **Nuk akreditohet** programi i studimit të Kolegjit UBT:
 12. *Film dhe Televizion, BA*, 180 ECTS.

- V. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.

- VI. Obligohet Kolegji UBT që deri më datë 15.11.2022 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- VII. Obligohet Kolegji UBT që për çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit të raportojë dhe arsyetojë në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovohet nga KSHC.
- VIII. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji UBT në afatin ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë;

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc, 180 ECTS</i> Riakreditim	Vehebi Sofiu Ermira Daka Abedin Sutaj Edmond Jajaga Astrit Hulaj Besnik Qehaja
2.	<i>Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, MSc, 120 ECTS</i> Riakreditim	Mehmet Shala Yll Haxhimusa Edon Maliqi Xhafer Krasniqi
3.	<i>E drejta Civile dhe e Pronës, LLM, 60 ECTS</i> Riakreditim	Artan Qerkini Mentor Shaqiri
4.	<i>Arti dhe Mediat Dixhitale, BA, 180 ECTS</i> Riakreditim	Alban Muja Gazmend Ejupi Fitore Isufi Arben Arifi Adelina Thaqi
5.	<i>Inxhinieri e Mekatronikës, BSc, 180 ECTS</i> Riakreditim	Bertan Karahoda Drita Qerimi Agron Millaku Fatmir Azemi
6.	<i>Inxhinieri e Mekatronikës, MSc, 180 ECTS</i> Riakreditim	Luan Mulaku Naim Preniqi Betim Shabani
7.	<i>Teknik i Radiologjisë, BSc, 180 ECTS</i> Riakreditim	Ilir Ahmetgjekaj Arben Kutllovci Isak Aliji Mevlan Qafleshi

8.	<i>Shëndeti dhe Aktiviteti Fizik, MSc, 120 ECTS</i> Akreditim	Avdi Pireva Milaim Berisha Besir Shaqiri Artan Kryeziu
9.	<i>Biokimi Mjekësore, BSc, 180 ECTS</i> Akreditim	Linda Çarkaxhiu Afrim Zeqiraj Zafer Gashi Naser Kamberi Suzana Aliu Cengis çesko Kujtim Thaqi Diellor Rizaj
10.	<i>Shkenca Paramjekësore, BA, 180 ECTS</i> Akreditim	Zaim Gashi Vjosa Mulliqi - Kotorri Zejnë Buja
11.	<i>Aktrim, BA, 180 ECTS</i> Akreditim	Alban Zogaj Fiona Gllavica Fatlume Bunjaku
12.	<i>Film dhe Televizion, BA, 180 ECTS</i> Akreditim	Gazmend Nela Orhan Kerkezi Anisa Rada

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin UBT me këtë përbërje: Josip Balen, Peeter Normak, Chris Richter, Kenneth Wann, Mihaly Boros, Darko Lukic, Oana Sarbu, Diana Milcic, Tea Marohnic, Andreas Mehrle, Domagoj Vugic, Delia Gologan, Rebecca Maxwell, Katerina Klimoska, Asnate Kazoka, Martins Upmacis, Ketevani Kankava, Artur Tventanii dhe Jadranka Pelikan. Vizitat janë organizuar në datat: 23.03.2022, 31.03.2022, 06.04.2022, 07.04.2022, 25.05.2022 dhe 09.06.2022.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit dhe për secilin program, për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit *Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc, 180 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht katër (4) standarde dhe substancialisht tri (3) standarde.
2. Për programin e studimit *Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, MSc, 120 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht katër (4) dhe substancialisht tri (3) standarde.
3. Për programin e studimit *E drejta Civile dhe e Pronës, LLM, 60 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht shtatë (7) standarde.
4. Për programin e studimit *Arti dhe Mediat Dixhitale, BA, 180 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht shtatë (7) standarde.
5. Për programin e studimit *Inxhinieri e Mekatronikës, BSc, 180 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht tri (3), substancialisht dy (2) dhe pjesërisht dy (2) standarde.
6. Për programin e studimit *Inxhinieri e Mekatronikës MSc, 180 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1), substancialisht katër (4) dhe pjesërisht dy (2) standarde.


7. Për programin e studimit *Teknik i Radiologjisë BSc*, 180 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht dy (2) dhe substancialisht pesë (5) standarde.
8. Për programin e studimit *Shëndeti dhe Aktiviteti Fizik, MSc*, 120 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht katër (4) dhe pjesërisht tri (3) standarde.
9. Për programin e studimit *Biokimi Mjekësore, BSc*, 180 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1), substancialisht tri (3) dhe pjesërisht tri (3) standarde.
10. Për programin e studimit *Shkenca Paramjekësore, MSc*, 180 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht dy (2), substancialisht tri (3) dhe pjesërisht dy (2) standarde.
11. Për programin e studimit *Aktrim, BSc*, 180 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht dy (2), substancialisht katër (4) dhe pjesërisht një (1) standard.
12. Për programin e studimit *Film dhe Televizion, BA*, 180 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht dy (2) dhe pjesërisht pesë (5) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 101 të mbajtur më 30.06.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit UBT dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditë nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit UBT;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasrudo Nazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

